



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 1880 Prot.

Tiranë, më 31.3. 2021

UDHËZIM

Nr. 6, datë 31.3. 2021

PËR

**ZHVILLIMIN E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT
FILLOR, VITI SHKOLLOR 2020-2021**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe të nenit 50, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor më datë 21 Maj 2021, për të gjithë nxënësit e klasave të pesta.
2. Testi është i integruar dhe përfshin lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre.
3. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, fillon në orën 10.00 dhe zgjat 1 orë e 30 minuta.
4. Nxënësi duhet të paraqitet 1 (një) orë përpara në qendrën ku zhvillohet testi.
5. Procedurat e hartimit dhe të vlerësimit të testeve përcaktohen në rregulloren "*Për procedurat e organizimit dhe të zhvillimit të vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor*", miratuar me urdhrin nr. 78, datë 27.02.2020.
6. Nxënësit me aftësi të kufizuara e zhvillojnë vlerësimin e arritjeve bazuar në planin edukativ individual me të cilin punojnë dhe në përshtatje me veçoritë e tyre.
7. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QShA), një ditë para zhvillimit të vlerësimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.
8. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, (DPAP) monitoron procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor dhe raporton për çdo parregullsi të vërejtur gjatë zhvillimit të tij.
9. Arkivimi i testeve bëhet pranë Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP).
10. ZVAP merr nga Qendra e Vlerësimit të Testit dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të jashtëm dhe të mjediseve ku është realizuar vlerësimi i arritjeve të

nxënësve të arsimit fillor. Këto të dhëna dërgohen në QSHA, në DPAP dhe në Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar.

11. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjensia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

EVIS KUSHI

